REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.539 prot.

Lushnje më, 14/01/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU

"MBI NJË NDRYSHIM TË *VKB-SË NR 121 DATË 23.12.2025* "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE NË VARËSI DHE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026 "

Të nderuar zonja dhe zoterinjë këshilltarë!

Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi dhe politikave për përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të punonjësve, ju paraqesim këtë relacion lidhur me zbatimin e pagës minimale për punonjësit e Bashkisë Lushnje dhe institucioneve në varësi të saj.
Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 19.12.2025 "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi", është përcaktuar paga minimale mujore në masën 50,000 lekë, e cila hyn në fuqi nga data 1 janar 2026.
Ky vendim synon rritjen e mirëqenies së punonjësve dhe përafrimin e pagave me kushtet ekonomike aktuale.
Në zbatim të këtij vendimi janë evidentuar pozicionet e punës ku paga është më e ulët se paga minimale e miratuar.
Për sa më sipër, propozojmë që Këshilli Bashkiak të miratojë zbatimin e pagës minimale në përputhje me VKM-në 776 datë 19.12.2025 *„Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.538/1 Prot.

Lushnje më, 14/01/2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 04 , DATË 14 / 01 / 2026

"MBI NJË NDRYSHIM TË *VKB-SË NR 121 DATË 23.12.2025* "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE NË VARËSI DHE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026 "

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës / / 2026 me propozim të kryetares së Bashkisë, si dhe në mbështetje të nenit 8 pika 2,nenit 9 pika 1.1, shkronja b,nenit 54 shkronja ç, neni 55, pika 2 dhe 6 te Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, Vendim Nr. 422, datë 26.6.2024 „Për një ndryshim në Vendimin Nr. 326, Datë 31.5.2023, Të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike", të ndryshuar,*Vendimit Nr. 776, datë 19.12.2025 „Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"* , të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1996, "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar , Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi të jetë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

PROPOZOJMË :

1. Te Lidhja Nr.3 bëhen këto ndryshime:
   -pika 4 nga 51,000 bëhët 54,000 .
   -pikat 5, 6,7,8,9,10,11 paga bazë bëhet 50,000.

2. Te Lidhja Nr.4 bëhen këto ndryshime:
   -pikat me numër 5 dhe 6 paga bazë bëhet 50,000.

3. Te Lidhja Nr.5 bëhen këto ndryshime:
   -pika 16 nga 51,000 bëhet 54,000

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

-pika 18 për pozicionin kujdestar/sanitare paga bazë bëhet 50,000 lekë.

-pikat 20,21,22,23,24,25, paga bazë 50,000 lekë.

4. Te Lidhja Nr.6 bëhen këto ndryshime:

-pikat 9,10,11 paga bazë bëhet 50,000 lekë.

5.Efektet financiare të këtij vendimi sipas VKM-së Nr. 776 datë 19.12.2025 fillojnë nga data 1 janar 2026.

6.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Institucionet në varësi.

7.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

Drejtoria e Financës
Ervisa Çuko

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Kryetar i Bashkisë
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com